

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AUTO CORRECT" SHPK

Sot me daten 03/11/2025 (dymijë e njëzet e pesë), unë ortaku themelues :

- **I Z. RONALDO LACI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14 Mars 1998, lindur në Fushe Kruje dhe banues në Kruje, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. ID J803140611.
- Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " AUTO CORRECT" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " AUTO CORRECT" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Njësi me Nr Pasurie 140/48, Zone Kadastrale 2385, Krujë, Larushk,

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Pjesë kembimi te përdorura, Autoservis, Shitje Blerje automjetesh, Import-Export të automjeteve dhe pjesëve të kembimit të përdorura.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " AUTO CORRECT" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kontributi i ortakeve është i ndarë si vijon:

- 1. Ronaldo Laçi zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË



Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Ronaldo Laçi, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Kruje për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
" AUTO CORRECT" SH.P.K**